



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 060-21165 /22

Klinë, dt: 22.06. /22

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e IV-të e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 13.5.2022, me fillim nga ora 9:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e komitetit, drejtorët dhe gjithë të pranishmit të cilët ishin pjesëmarrës në mbledhje të KPF-së.

Kryesuesi theksoi se të gjithë janë prezent dhe mund të filloj me punë.

Gjithashtu, theksoi se përveç pikave të cilat janë për shqyrtim në rend dite, kemi edhe një kërkesë për një pikë shtesë, e cila është kërkuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Kërkesë që ta vënë në rend të ditës edhe një pikë shtesë që është Draft-strategjia për zhvillim ekonomik lokal 2022-2027.

Më pas, Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin Prill - Maj 2022,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi hapi debat rreth rendit të ditës, bashkë me kërkesën e parashtruar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Pasi të gjithë u dakorduan për rend dite, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës.

Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 7 vota PËR, u miratua rendi i ditës së bashku me kërkesën e parashtruar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Fadil Gashi, kryesues: Të gjithë anëtarët e Komitetit janë prezent.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Fadil Gashi, Kryesues: Nëse ka dikush diçka rreth procesverbalit nga seanca e kaluar urdhëroni!

Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, Kryesuesi hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin Prill - Maj 2022.

Kryesuesi vazhdoi me prezantimin e kërkesave.

Kërkesa 1. Kërkesë e parashtruar nga z. Hazir Tigani, kryetar i Këshillit të prindërve të komunës së Klinës, i cili kërkon që me rastin e zgjedhjes së tij në këtë post të jetë anëtar në Këshillin e Komunal për Siguri në Bashkësi në mënyrë që t'i adresojë sugjerimet dhe kërkesat në këtë këshill.

Fadil Gashi, Kryesues: Me thënë të drejtën, ne po jemi të obliguar ti shqyrtojmë disa kërkesa sepse po na drejtohen pa te drejt, natyra e kësaj kërkesa s'ka të bëj me shqyrtimin e saj Komiteti; megjithatë ne po e shqyrtojmë, nëse pajtoheni po e rekomandojmë në Kuvend. Kush është për?

Kryesuesi hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, u miratua që kërkesa të dërgohet në Kuvend.

Kërkesa 2. Kërkesë e parashtruar nga znj. Nazife Qallapeku (fshati Shtupel, komuna Klinë) për strehim të përhershëm, e cila sipas shkresës së përpiluar nga Agjencia për ndihmë juridike falas, Zyra rajonale Pejë dhe nënshkruar nga znj. Nazife Qallapeku, thekson se ka jetuar dhe vazhdon të jetojë në shtëpinë e bashkëshortit me dy fëmijët e tyre, por pasi që bashkëshortit i është shfaqur sëmundje (çrrregullim psikik- i shkallës së katërt i skizofrenisë) nuk mund të jetojnë së bashku në një shtëpi për arsy se ka pasur vazhdimit dhunë dhe për këtë arsy Gjykata themelore në Pejë - dega Klinë, ka nxjerrë aktvendim për masë mbrojtëse ndaj viktimës për gjashtë muaj ku i ndalohet bashkëshortit qëndrimi në shtëpi. Gjithashtu, thekson se ka pasur edhe kërcënime nga ana e bashkëshortit se momentin e kthimit në shtëpi do t'i dëbojë nga shtëpia.

Tunë Dedaj: Përshëndetje kryesues për ju dhe për të gjithë të pranishmit këtu! Unë e pashë dhe e lexova me vëmendje kërkesën e saj, po unë e shoh si të arsyeshme që kjo t'u drejtohet organeve përkatëse që i takon, që mund t'i bëjnë zgjidhje. Se sa i përket kërkesës së saj edhe unë jam se kësaj me i bërë zgjidhje, por ndoshta do të ishte shumë zgjidhje më e mirë që bashkëshorti i saj t'merret dhe të dërgohet diku ku ka shërim e të shërohet, se jo të largohet dhe të ndahet prej familjes krejt, kaq.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit Tunë! Ne mund ta rekomandojmë në Kuvend, mund t'i drejtohemë edhe njëherë Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, le të merren edhe ata qoftë për banim, qoftë për asistencë tjetër, qoftë edhe për atë që thua ti, por ne si komitet e kemi pak të hendikepuar të bëjmë diçka më shumë. Vetëm për të kërkuar prej këtyre institucioneve, prej Drejtorisë dhe prej Qendrës sociale po edhe faktorëve tjerë, do të thotë duke e përfshirë edhe programin e banimit nëse eventualisht ka hapësirë, jo veç të kësaj, po edhe raste tjera si kjo, nëse ballafaqohet kushdo, a po pajtoheni? Kush është për?

Kryesuesi hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, u rekomandua që kërkesa t'u drejtohet institucioneve komunale, Qendrës për Punë Sociale dhe Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Pika e radhës: Draft- Strategja për zhvillim ekonomik lokal 2022-2027.

Fadil Gashi, Kryesues: Është një draft bukur i gjerë, por besoj ju veç e keni pranuar në adresë elektronike. Urdhëro Ajet një prezantim të shkurtër, ne prap do ta shqyrtojmë pas debatit publik në detaje, ne sot veç kemi me marr një vendim për me rekomandu për me lëshu për dëgjim publik.

Ajet Sejdiu: Përshëndetje kryesues, përshëndetje anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa. Siç e tha Kryesuesi, ne sot duhet me marrë një vendim për me u rekomandu për seancën e ardhshme, është Strategja zhvillimore e komunës së Klinës, e gatshme për të dalë në diskutim publik. Është kompania që e ka punuar në bazë të Ligjit për prokurimin, është kompani profesionale kështu që është material bukur i gjerë siç e tha Kryesuesi. Nëse dashironi me i zbërthye unë jam i gatshëm, por kjo vetëm është për t'u marrë vendimi me dalë diskutim publik. Kështu që kjo prapë ka me ardh në këtë komitet për aprovim edhe në seancën e kuvendit që është kompetente për me aprovu.

Fadil Gashi, Kryesues: Po, faleminderit Ajet! Po pajtohemi me të se është material bukur i gjerë. Në këtë rast edhe kompania Albo Group që i ka hartuar këto, ndoshta nuk do të ishte ide e keqe, kështu si propozim, të organizojmë ndonjë takim me këta, nuk do të thotë vetëm brenda kufijve të Kosovës, si Komitet, që mirë është të debatojmë edhe ne me këtë grupin.

Ajet Sejdiu: Patjetër, patjetër! Ne duhet të kërkojmë që në seancën që e aprovojmë ose në diskutim me qytetarët, të gjitha grupet e interesit të vijnë dhe ti prezantojnë në mënyrë profesionale. Plus nëse munden me përgatit edhe me sllajde kështu me monitor, çdo çështje që është e paraparë me strategji.

Tunë Dedaj: Kryesues, unë jam ndër ata që kam qenë në Durrës kur është bërë Strategjia e përparshme afatgjate e zhvillimit ekonomik lokal të komunës së Klinës. Edhe përnjëmend ka qenë një kuvend pune shumë i mirë atje, është punuar bukur shumë, do të thotë se do të del në diskutim publik, pajtohem me dërgu në Kuvend, ne deri në Kuvend edhe mund ta lexojmë, por është mirë me mendu për ta bërë një agjendë.

Fadil Gashi, Kryesues: A ka dikush tjetër rreth draftit? Kjo është shumë e rëndësishme se do të varet gjithë orientimi i çmimeve, i politikave investuese, i buxheteve, projekteve dhe gjithçka tjetër deri në 2027-tën madje edhe kur fillojnë të ndërtohen buxhetet për çdo vit fiskal, këtë e ka bazë (pikënisje). Ju kisha kërkuar të gjithëve për kontributin maksimal edhe në konsultim të dokumentit edhe në plotësim edhe në propozim edhe në gjithçka tjetër, edhe kur ta merr votën në asamble me qenë dokument përnjëmend i mirë edhe i përgatitur edhe se u hyn në shërbim krejt këtyre prioritetave që i kanë qytetarët, se në fund të fundit ky përkthehet në të mirat e qytetarëve dhe në mirëqenien e tyre.

Tunë Dedaj: Unë personalisht p.sh. do të angazhohem që në këtë dokument me parapa çdo pëllëmbë toke brenda komunës së Klinës mundësish me u ujit, me u krijuar kushtet për hidro tokave, edhe këtu parashihet, për këtë është kjo, për këtë bëhet.

Kryesuesi pas përfundimit të debatit, hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, Komiteti për Politikë dhe Financa rekomandoi që draft strategjia për zhvillim ekonomik lokal për vitin 2022-2027 të kaloj për shqyrtim në Kuvend dhe të merret vendim për ta ven në shqyrtim publik.

7. Të ndryshme.

Fadil Gashi, Kryesues: Në të ndryshme, nëse ka dikush?

Tunë Dedaj: Ka qenë mirë për ta paraparë një pikë të veçantë në Kuvend për problemin e genve endacakë. Ajo që po bëjnë kompanitë nuk është zgjidhje, unë e di se komuna nuk e ka mundësinë financiare, por është mirë që ne të angazhohemi në maksimum në seancë, ta thërrasim seancën, ndoshta jo të jashtëzakonshme, por një pikë të rendit të ditës të jetë vetëm për këtë problematikë. Kështu që edhe Ministrisë së Pushtetit Lokal edhe Kryeministrin t'i bjerë në vesh që situata sidomos në Klinë me qentë endacakë është shumë e keqe.

Fadil Gashi, Kryesues: Ndoshta do të ishte mirë të dalë si rekomandim, nëse pajtohen edhe tjerët, që le të vjen një njoftim në seancën e radhës, vetëm njoftim se çka është ndërmarrë dhe çka mund të presim ne që të bëjmë një pikë të veçantë, është një çështje që nuk është vetëm për Klinën.

Tunë Dedaj: Unë mendoj personalisht se nuk po bëhet zgjidhje, krahas asaj është problem edhe për fëmijët që shkojnë në shkollë, për të rriturit, për pleqtë që dalin të ecin me rekomandim të mjekut, është problem që tash po i prishin edhe fushat që janë të mbjella me grurë, një hektarë grurë me mbjell kushton mbi 1500 euro dhe me ja prish tokën, për bujkun nuk ka diçka më keq.

Fadil Gashi, Kryesues: Nëse pajtoheni, ne mund ta quesim si rend ditës dhe e diskutojmë në rend dite, apo pajtoheni?

Kryesuesi hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, Komiteti për Politikë dhe Financa rekomandoi që për seancën e radhës të futet si rend dite çështja e qenve endacakë.

Fadil Gashi, Kryesues: Nëse s'keni diçka për të shtuar, ju falënderoj shumë për pjesëmarrje dhe për angazhim. Me kaq po e mbylli mbledhjen e rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Procesmbajtësja,
Monika Palushi

Palushi



**Kryesuesi,
Fadil Gashi**

Fadil Gashi